

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Lamborghini: Supermakinat e së ardhmes duhet të ofrojnë më shumë se shpejtësi
ADRESA	https://albeu.com/teknologji/auto/lamborghini-supermakinat-e-se-ardhmes-duhet-te-ofrojne-me-shume-se-shpejtesi/1032413/
BURIMI	albeu.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	29 shtator 2026, 10:46:11 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	29 shtator 2026, 10:44:59 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	7c5e39700afa84aa1931e706e007c891f62ef94ac28aa37939b192e79ff71f62
TEKSTI	5a0a798ca23461706c26d9fe2a08d71a1e06bbf4b6b4ba3d16bdb3d091be2f24
PAMJA	076a8f30050a4135faf6f29fa658cea635d353091bf7787688bc118d3714d57b

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	3ed6fb4d2342be389faeea2a2f2b605e7ff31721a7c5a8434f812fb08f7fd302
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/3ed6fb4d2342be389faeea2a2f2b605e7ff31721a7c5a8434f812fb08f7fd302>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Lamborghini: Supermakinat e së ardhmes duhet të ofrojnë më shumë se shpejtësi



Për një kohë të gjatë, receta e një supermakine dukej e pandryshueshme: performancë e jashtëzakonshme, pamje tërheqëse, motor i veçantë dhe një çmim shumë i lartë. Lamborghini mendon se sot kjo qasje nuk është më e mjaftueshme.

Prodhuesi italian vëren se përparimi i teknologjisë elektrike ka bërë që edhe limuzinat dhe SUV-të elektrikë të arrijnë përshpejtimin nga 0 në 100 km/h për afërsisht tre sekonda. Për këtë arsye, shpejtësia e pastër nuk ka më të njëjtën peshë si dikur në përcaktimin e një supermakine.

Paolo Racchetti, përgjegjës për linjën e modelit Temerario, deklaroi për CarExpert në Milano se performanca vazhdon të jetë një element kyç, por një automjet i këtij lloji nuk mund të vlerësohet vetëm përmes shifrave të përshpejtimin.

"Shpejtësia është ende një pjesë e rëndësishme e performancës, por është e qartë se ajo është e domosdoshme, por jo e mjaftueshme, që një makinë të quhet supermakinë", u shpreh Racchetti.

Sipas tij, rëndësi më të madhe do të ftojnë sjellja e automjetit në rrugë, aftësitë dinamike dhe, mbi të gjitha, emocionin që përjeton personi në timon.

"Një supermakinë nuk duhet të ofrojë vetëm përshpejtim dhe shpejtësi, por edhe emocion", theksoi ai, transmeton Telegrafi.

Kjo filozofi e Lamborghini-t shfaqet në një periudhë kur elektrifikimi po e bën gjithnjë e më të zakonshme performancën ekstreme. Automjetet elektrike tashmë arrijnë rezultate që dikur ishin karakteristikë vetëm e supermakinave më të kushtueshme.

Lamborghini, marka që në vitet '60 kontribuoi në formësimin e segmentit të supermakinave përmes ikonës Miura,

të fundit /



Koha e tepërt para ekranit mund të ndikojë te fëmijët më shumë ...



Rita Ora siguron patentën pas 12 vitesh, ndan momentin e...



Shpërthim i fuqishëm në një pikë karburanti në Sarandë, dy...



Nga Metz-i, Leoni XIV i kërkon Europës të zgjedhë paqen dhe të...



Shtatë vite burg për ish-infermierin që abuzoi seksualisht me...



Një profil rus e kërcënon publikisht Ramush Haradinajn



Plagosje me mjet prerës në Maliq, dy persona konfliktohen...



ARTIKULL JOETIK?

Esim for Global | Esim for Europe | Esim for Caribbean | Esim for USA | Esim for Italy | Esim for Spain | Esim for Turkey | Esim for Germany | Esim for Greece | Esim for Asia | Esim for World Cup 2026 | Esim for Saudi Arabia | Esim for Egypt | Esim for United Arab Emirates | Esim for Balkans | Esim for Morocco | Esim for China | Esim for United Kingdom | Esim for Africa | Esim for Latin America | Esim for GCC Gulf Cooperation Council | Esim for Middle East | Esim for South America | Esim for Canada | Esim for Mexico | Esim for Japan | Esim for Albania | Esim for Kosovo | Esim for Switzerland | Esim for Tunisia | Esim for South Africa | Esim for Algeria | Esim for Portugal | Esim for Brazil | Esim for Argentina | Esim for Colombia | Esim for Hong Kong | Esim for Thailand | Esim for Macau | Esim for Malaysia | Esim for Vietnam | Esim for South Korea | Esim for Austria | Esim for Netherlands | Esim for Australia | Esim for Russia | Esim for India | Esim for Chile | Esim for Peru | Esim for Poland | Esim for North Macedonia | Esim for Sweden | Esim for Finland | Esim for Norway | Esim for Belgium

nuk duket se dëshiron që modelet e saj të njihen thjesht si automjete me shpejtësi të lartë.

Kjo qasje lidhet edhe me mënyrën se si kompania po e trajton elektrifikimin. CEO-ja Stephan Winkelmann ka bërë të ditur më herët se modeli i parë plotësisht elektrik i Lamborghini-t është shtyrë pa një afat të përcaktuar, ndërsa puna për zhvillimin e tij vijon.

Në vend të një supermakine tërësisht elektrike, modeli i katërt i gamës së kompanisë, një GT 2+2 i bazuar në frymëzimin e konceptit Lanzador, pritet të pajiset me një sistem hibrid plug-in.

Megjithatë, kjo nuk nënkupton se Lamborghini po e braktis elektrifikimin. Revuelto, Temerario dhe Urus SE tashmë janë të pajisura me teknologji elektrike në forma të ndryshme.

Synimi i kompanisë është që elektrifikimi të mos i shndërrojë modelet e saj në automjete që vlerësohen vetëm për kohën e nevojshme për të kaluar nga 0 në 100 km/h.

Ndërkohë, rikthimi i transmisionit manual nuk është pjesë e planeve të afërta të markës. Racchetti pranoi se do të ketë gjithmonë blerës që e kërkojnë kambion manuale për shkak të lidhjes së saj me historinë dhe traditën e Lamborghini-t.

Megjithatë, ai theksoi se kompania duhet të vijojë përpara, duke iu përshtatur zhvillimeve të së ardhmes.

Për Lamborghini-n, sfida e ardhshme nuk konsiston vetëm në krijimin e një automjeti më të shpejtë se modeli paraardhës. Marka duhet të ruajë edhe ndjesinë e veçantë që e ka shndërruar në një nga emrat më të njohur të industrisë së supermakinave.

Ndërsa shpejtësia ekstreme po bëhet më e zakonshme në treg, Lamborghini synon të veçohet për një element që nuk mund të përmbledhet në të dhënat e kronometrit: emocionin që përjetohet pas timonit. /Telegrafi/

Shtuar më 29.09.2026 12:44

Tags: [lamborghini](#)



ID.4 ndryshon emër: Volkswagen përgatit SUV-in elektrik ID. Tiguan



Rreth 300 makina klasike dalin në ankand në SHBA, me oferta fillestare prej 5...



Gjenerata e re e BMW Serisë 3 debuton së shpejti me dizajn dhe teknologji t...



Mercedes-Benz përballlet me mundësinë e mbylljes së fabrikave në Gjermani



Një robot kosites i frymëzuar nga Golf MK2 GTI punon në mënyrë...



Audi A6 elektrik përshkon 1,338 kilometra me një karikim dhe vendos rekor...



Volkswagen zgjeron hapësirën e ngarkesës te furgoni elektrik ID. Buzz...



Lamborghini po shqyrton një Temerario të përshtatur për terrene të vështira



© 2003 - Albeu Online Media. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara!

Kërko...

Kërko

Kryesore

Erion Veliaj
Free Esim
Zgjedhjet 2025
Belinda Balluku
SPAK

Kategori

Lifestyle
Showbiz
Tech
Shëndetësi
Arratim

Linqet

Live tv shqiptare
Moti në Shqipëri
Travel
Horoskopi
Livescore

Tags

Edi Rama
Albania News
Ilir Meta
Piranjat

Moti

Moti në Tiranë
Moti në Prishtinë
Moti në Shkup
Moti në Durrës
Moti në Prizren

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.